



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:196600

Datë: 25.07.2024

Numri i dokumentit: 05983352

KE.nr.1390/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit Jona N.T.P, me seli në Pozhoran, Komuna e Vitisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Visar Musa, avokat nga Ferizaji, kundër të paditurit SH.B. nga Gjilani rr. “Hivzi Sylejmani” nr.262, me objekt kontesti kthim i borxhit, vlera e kontestit 1,500.00€, jashtë seancës me datën 25.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas padisë së paditësit Jona N.T.P me numër të lëndës KE.nr.1390/22 (2021:196600) të datës 03.09.2021, kundër të paditurit SH.B., me objekt kontesti kthim borxhi.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Jona N.T.P, me datë 03.09.2021, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik , kundër të paditurit SH.B. nga Gjilani, me të cilën kanë kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e paditësit dhe të obligohet i padituri që t’ia kthejë borxhin në vlerë prej 1500.00€, e cila lëndë pas themelimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës është transferuar në këtë gjykatë.

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata

Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*.

Meqenëse në rastin konkret çështja juridike kontestimore zhvillohet në mes të paditësit si person juridik dhe të paditurit si person fizik, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), lidhur me nenin 37 dhe 38 të LPK-së, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Gjiilan.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1390/22, datë 25.07.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.